

VENDIM
Nr. 912, datë 22.12.2014

**PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN “RSM” TË NATO-S, PRANË
KOMANDËS SË BATALIONIT SHUMËKOMBËSH, NË AFGANISTAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të një toge të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga 30 (tridhjetë) ushtarakë, pranë Komandës së Batalionit Shumëkombësh, në varësi të Shtabit të Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Kabul (TAAC - Capital), në Afganistan.

2. Misioni i togës është ruajtja e Aeroportit Ndërkombëtar të Kabulit (KAIA), në kuadër të operacionit të NATO-s “RSM”, në Afganistan.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit të parë në Afganistan. Periudha e qëndrimit në mision për çdo përfaqësues do të jetë me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik).

4. Venddislokimi i kësaj toge të jetë në Aeroportin Ndërkombëtar të Kabulit (KAIA), në Afganistan.

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) aktivitete social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

ë) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit, që do të shërbejë në Afganistan, dërgimi, ndërrimi dhe kthimi pas përfundimit të detyrës për në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lanterieria, transporti i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy - ose shumëpalëshe ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

